



EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

të mbledhjes së tretë të Kuvendit të Komunës së Prishtinës, e mbajtur më 27.05.2016, e cila filloi në orën 10:00.

Në mbledhje morën pjesë: Halim Halimi, kryesues i Kuvendit, Shpend Ahmeti, kryetar, këshilltarët e Kuvendit: Sami Hamiti, shef i GP-së (LDK), Hazir Borovci (LDK), Agim Gashi (LDK), Shefki Gashi (LDK), Sokol Krasniqi (LDK), Shaip Hajrizi (LDK), Muhamet Nura (LDK), Mustafë Krasniqi (LDK), Vjollca Dibra - Ibrahimimi (LDK), Besa Rafuna (LDK), Shiqeri Spahiu (LDK), Ajnishahe Azemi (LDK), Merita Surkishi (LDK), Qëndron Kastrati, shef i GP-së (LVV), Sylejman Pireva (LVV), Hatixhe Hoxha (LVV), Genc Sherifi (LVV), Teuta Krasniqi (LVV), Bardha Dida – Rogova (LVV), Hatixhe Latifi – Pupovci (LVV), Ylli Hoxha (LVV), Kreshnik Ahmeti (LVV), Sadri Ramabaja (LVV), Lirak Çelaj, shef i GP-së (PDK), Shemsi Veseli (PDK), Lirie Avdiu (PDK), Muhamet Selmani (PDK), Laura Zherka (PDK), Mirlinda Sopi (AKR), Sami Boroci, (AKR), Sofije Bunjaku (AKR), Remzi Pacolli (AKR), Rita Begolli (AAK-LDD), Fadil Gashi (AAK-LDD), Feti Mehdiu, shef i GP-së (PD), Kimet Zeqa (PD), Abetare Fazliu, përfaqësuese e subjektit politik (LB), Visar Arifaj, përfaqësues i subjektit politik PF, Nenad Miladinoviçi, përfaqësues i subjektit politik GIS dhe Abit Kastrati.

Munguan: Vlora Dumoshi (LDK), Naime Osmani (LDK), Hasime Krasniqi (LDK), Flamur Shala (LDK), Shaip Shabani (PDK), Blerand Stavileci (PDK), Lirijeta Rexhepi (PDK), Imer Rusinovci (AAK-LDD) dhe Brahim Mehmetaj, shef i GP-së (AAK-LDD).

Të pranishëm ishin edhe përfaqësues të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, përfaqësues të OJQ-ve, përfaqësues të mediave të shkruara dhe elektronike, përfaqësues të KFOR-it dhe përfaqësues të OSBE-së.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi **Halim Halimi**, kryesues. Kryesuesi hapi diskutimin për rendin e ditës.

Kryetari, Shpend Ahmeti, i njoftoi të pranishmit se para më shumë se tri vite Komuna e Prishtinës, në kohën e mandatit të ish-kryetarit të Komunës, është dakorduar me KFW-në gjermane për një kredi, për katër komuna të Republikës së Kosovës, për efikasitet të energjisë në ndërtesa publike. Lidhur me këtë tha se nevojitet së paku një shumë prej 50 000 eurove në një linjë buxhetore, me çka tregojmë zotimin tonë për të marrë pjesë në këtë projekt.

Nenad Miladinoviqi tha se komuniteti boshnjak ka dërguar kërkesën për zëvendësimin e anëtarit nga radha tyre në Komitetin për komunitete.

Sadri Ramabaja theksoi se në mbledhjen e kaluar kam propozuar dy pika, por në rendin e ditës nuk ishin, megjithëse në këtë Kuvend nuk pati asnjë zë kundër, që ato të futen në rend dite për mbledhjen e sotme. Fjala është për një kërkesë të Bashkësisë hebreje “Bet Israel Kosova”, që ndërlidhet me ndërtimin e një sinagoge në qytetin e Prishtinës.

Çështja e dytë ka të bëjë me Komisionin për emërimin dhe riemërimin rrugëve, shesheve etj., për çka kemi nxitur gjithashtu reagime të mëdha. Këtë çështje e kam shpjeguar për emra të veçantë të personaliteteve të kulturës, historisë etj., të cilëve u është hequr emri i rrugëve, andaj kërkoi që këto çështje të futen në rend dite për diskutim.

Për çështje e sinagogës, sqarime të nevojshme dha kryetari, z. **Shpend Ahmeti**.

Për rendin e ditës diskutuan edhe Sami Hamiti dhe Lirak Çelaj, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

*Kryesuesi konstatoi se njëzëri u përkrah propozimi i z. Ramabaja, që në pikën e rendit të ditës të futet si: “Deklaratë për ndërtimin e sinagogës për Bashkësinë Hebreje”.
Po ashtu, njëzëri u përkrah edhe propozimi i Kryetarit, që ka të bëjë me transferimin e mjeteve për projektin e efijencës së energjisë me KFW-në.*

Kryesuesi konstatoi se njëzëri u miratua ky

R E N D I D I T Ë S:

1. Propozimvendimi për ndryshimin e vendimit për formimin e Komitetit për Politikë dhe Financa;
2. Propozimvendimi për plotësimin-ndryshimin e Rregullores për tarifa, ngarkesa dhe gjoba komunale;
3. Propozimvendimi për lënien në diskutim publik të Rregullores për menaxhimin e mbeturinave;
4. Shqyrtimi i miratimit të Planit lokal të veprimit për riintegrimin e personave të riatdhesuar;
5. Propozimvendimi për dhënien e pronës komunale KEDS-it;
6. Propozimvendimi për transferimin e mjeteve për projektin e efijencës së energjisë me KFW-në;
7. Deklaratë rreth ndërtimit të sinagogës së Bashkësisë Hebreje;
8. Propozimvendimi për ndryshimin e vendimit për formimin e Komitetit për komunitete;
9. Pyetje dhe përgjigje.

Pika e parë

Propozimvendimi për ndryshimin e vendimit për formimin e Komitetit për Politikë dhe Financa.

Sami Boroci, në emër të GP të AKR-së, për anëtarë të Komitetit për Politikë dhe Financa në vend të z. Islam Pacolli, propozoi znj. Mirlinda Sopi.

Për këtë pikë diskutuan edhe Qëndron Kastrati, Feti Mehdiu dhe Ylli Hoxha, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Kryesuesi konstatoi se me 25 (njëzet e pesë) vota për dhe 14 (katërmbëdhjetë) kundër, u miratua Vendimi për ndryshimin e vendimit për formimin e Komitetit për Politikë dhe Financa.

Pika e dytë

Propozimvendimi për plotësim-ndryshimin e Rregullores për tarifa, ngarkesa dhe gjoba komunale.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri u miratua vendimi për plotësim-ndryshimin e Rregullores për tarifa, ngarkesa dhe gjoba komunale.

Pika e tretë

Propozimvendimi për lënien në diskutim publik të Rregullores për menaxhimin e mbeturinave.

Për këtë pikë diskutuan: Shpend Ahmeti, kryetar, Agim Gashi, Kreshnik Ahmeti, Merita Surkishi, Mirlinda Sopi, Hatixhe Latifi- Pupovci, Ylli Hoxha, Feti Mehdiu, Sylejman Pireva, Shefki Gashi, Lirak Çelaj, Sadri Ramabaja, Ajnishahe Azemi, Shemsi Veseli dhe Visar Arifaj, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Kryesuesi konstatoi se me 41 (dyzet e një) vota për, 1 (një) abstenim, u miratua vendimi për lënien në diskutim publik të Rregullores për menaxhimin e mbeturinave.

Pika e katërt

Shqyrtimi i miratimit të Planit lokal të veprimit për riintegrimin e personave të riatdhesuar.

Lidhur me shqyrtimin e miratimit të Planit lokal të veprimit për riintegrimin e personave të riatdhesuar, në pika të shkurtra të pranishmit i informoi Mustafë Neziri, zyrtar për integrim.

Për këtë pikë diskutuan edhe Kreshnik Ahmeti, Sadri Ramabaja dhe Ajnishahe Azemi, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri u miratua Planit lokal i veprimt për riintegrimin e personave të riatdhesuar.

Pika e pestë

Propozimvendimi për dhënien e pronës komunale KEDS-it.

Për këtë propozimvendim diskutuan: Shpend Ahmeti, kryetar, dhe Kreshnik Ahmeti, diskutime e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Kryesuesi konstatoi se me 33 (tridhjetë e tri) vota për, 1 (një) kundër dhe 3 (tri) abstenime, u miratua vendimi për dhënien e pronës komunale KEDS-it.

Pika e gjashtë

Proopozimvendimi për transferimin e mjeteve për projektin e efijencës së energjisë me KFW-në.

Shpend Ahmeti, kryetar, në pika të shkurtra i njoftoi të pranishmit rreth projektit të efijencës së energjisë me KFW-në.

Kryesuesi konstatoi se me 37 (tridhjetë e shtatë) vota për dhe 1 (një) abstenim, u miratua vendimi për transferimin e mjeteve për projektin e efijencës së energjisë me KFW-në, në shumë prej 50.000 euro.

Pika e shtatë

Deklaratë rreth ndërtimit të sinagogës së Bashkësisë Hebreje.

Lidhur me ndërtimin e sinagogës së Bashkësisë Hebreje diskutuan: Shpend Ahmeti, kryetar, Sadri Ramabaja, Feti Mehdiu, Muhamet Selmani dhe Ylli Hoxha, diskutime e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Kryesuesi konstatoi se me 33 (tridhjetë e tri) vota për, 6 (gjashtë) abstenime, përkrahjet iniciativa e Bashkësisë Hebreje për ndërtimin e sinagogës dhe obligohet ekzekutivi për gjetjen e një lokacioni të mundshëm për ndërtimin e saj.

Pika e tetë

Propozimvendimi për ndryshimin e vendimit për formimin e Komitetit për komunitete.

Kryesuesi tha se për zëvendësimin e anëtarit në këtë komitet, komuniteti boshnjak ka propozuar znj. Ulfeta Rexhepagiqi.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri u miratua vendimi për ndryshimin e vendimit për formimin e Komitetit për komunitete.

Pika e nëntë Pyetje dhe përgjigje

Pyetje e parashtruara për ekzekutivin nga anëtarët e kuvendit:

Sami Hamiti, ngriti çështjen e punës së Komisionit për emërtimin e rrugëve, duke thënë se ai komision nuk ka pasur të drejtë të bëjë ndryshim e emërtimit të rrugëve.

Kreshnik Ahmeti, ngriti për diskutim këto çështje:

- Është një kërkesë nga anëtarët e Komitetit për shërbime publike, që të bëhet kompensimi për mbledhjet e rregullta që mban ky komitet;
- Në mbledhjet e komitetit mungon anëtari nga subjekti politik i PDK-së (Blerand Stavileci) dhe kërkoi që të bëhet zëvendësimi i tij, pasi që mungesa e tij pengon edhe në kuorum. Me plotësimin e komitetit, diskutimet do të ishin më të frytshme.

Lirak Çelaj tha se nëse bënë nga jashtë të jetë anëtar i Komitetit për shërbime publike, do të përpiqemi që në mbledhjen e ardhshme t'i sjellim emrat dhe t'i plotësojmë këto komisione.

Fadil Gashi kërkoi nga kryesuesi që të diskutohet çështja e mospagesës së mëditjeve të anëtarëve të Kuvendit për mbledhjet të cilat po fillojnë dhe nuk përfundojnë.

Për çështjen e mospagesës së mëditjeve për anëtarët e Kuvendit, **kryesuesi** dha sqarime të nevojshme.

Sylejman Pireva parashtoi për diskutim këto çështje:

- Ka kërkesa të panumërta nga shfrytëzuesit e qoshqeve që nuk e paguajnë qiranë dhe nuk ju paguhet, nuk ju lejohet qiraja me muaj të tërë. Kërkoj të dije se sa do të zgjasë kjo dhe kur do të merret vendimi që ata ta ndërrojnë statusin, apo se çka do të ndodh me ta.
- Në rrugën "B", te rrethi, ku është ajo shitorja "Maksi Market", ka mbi 5-6 javë si dinosaur aty qëndron një makinë e rëndë që e ka zënë 1/3 e rrugës "Enver Maloku" dhe nuk e dimë a është e Komunës, apo është e ndonjë kompanie, por qëndron shumë keq aty dhe nuk është ndërmarrë asgjë. Unë e kam lajmëruar edhe Policinë dhe më kanë thënë shikoni me Komunën mos është çështje e Komunës kjo.

Për mos pagesën e anëtarëve të komiteteve, **Shemsi Veseli** tha se më vjen mirë që është përcjellë kërkesa te ekzekutivi për pagesën e tyre. Duhet ngulur këmbë përnjëherë t'i kthehet dinjiteti, sidomos kryeqendrës, gjersa kolegët tonë nëpër komunat tjera nuk i kanë këto probleme me i shtjelluar ose me i paraqitur, Komuna e Prishtinës duhet rregullisht, me vite të tëra, nuk ka të bëjë vetëm me këtë mandat, por edhe në mandatet e kaluara, e ka pasur të njëjtin problem.

Shaip Hajrizi, fillimisht ngriti çështjen e mospagesës për mbledhjet, edhe pse ato nuk kanë përfunduar, kur ne vijmë në mbledhje nënshkruhemi, andaj pse mos të paguhemi. Për këtë çështje nga kryesuesi kërkoj sqarim.

Ai parashtroi këto shqetësime të qytetarëve:

-**Te** hyrja e shkollës “Emin Duraku” pronarët e bizneseve të ndryshme ankohen, sepse para objekteve të tyre autobusët vijnë dhe qëndrojnë me një vend për një kohë të gjatë ndezur dhe për shkak të zhurmës dhe tymit të tyre, ata detyrohen që në këtë vapë vere me i mbyllur dyert e lokaleve. Kërkoj që të merren masa për këtë çështje.

-Pse nuk po ndërtohet parku mbi ish-Tjegulloren, ku aty veç është ndërtuar rruga dhe një parking i vogël për vetura.

Feti Mehdiu parashtroi këtë çështje:

-Është kërkesë e një grupi të qytetarëve që gjatë muajit të Ramazanit, të mos ketë ndërprerje të ujit, mundësisht të jetë 24 orë furnizim me ujë.

Remzi Pacolli kërkoi të dijë se a ka përfunduar plani i fizibilitetit për lagjen “Arbëria”. Nëse ka përfunduar ky plan, çfarë konkluzionesh janë nxjerrë nga matja e atij fizibiliteti. Kërkoj që përgjigja të më jepet për mbledhjen e radhës.

Agim Gashi pyetje për Drejtorinë e infrastrukturës lokale:

-Në rishikimin e buxhetit të vitit 2015 janë propozuar disa projekte të reja dhe janë miratuar nga Kuvendi, por në raportin e punës nuk e pash se shtrirja e rrjetit të ujësjellësit prej fshatit Llukar, nëpër Grashticë, deri në lagjet e fshatit Mramor, nuk është zhvilluar ai projekt.

Kërkoj që Drejtoria e Infrastrukturës të fillojë procedurat e tenderimit të atij projekti që ato fshatra të përfshihen në ato projekte.

Hatixhe Pupovci, ngriti këto shqetësime të qytetarëve:

-Në lagjen “Kodra e Diellit”, në afërsi të Qendrës së Mjekësisë Familjare, aty radhiten autobusët para ndërtesës dhe është shumë i vështirë kalimi i automjeteve, por edhe zhurma të cilën e bëjnë autobusët aty.

-Mendoj se është më se e domosdoshme që pyetjet të cilat po i paraqesim këtu në Kuvend, përgjigjet të na kthehen në mbledhjen e radhës së Kuvendit.

Shefki Gashi kërkoi të dijë se ku kanë shkuar ato mjete, në shumën prej 90 mijë euro, që janë ndarë për fizibilitet, për projektin e ujësjellësit Llukar – Mramor - Slivovë dhe deri më tani nuk kemi kurrfarë raporti. Askund nuk dihet çka është bërë me ato mjete, kah kanë shkuar dhe ku janë destinuar ato. Janë më se 26 fshatra të Malësisë së Gollakut që nuk kanë ujësjellës. Kërkoj që kjo kërkesë t’i përcillet ekzekutivit.

Bardha Rugova paraqiti një shqetësim rreth gjendjes së lojërave të fëmijëve në parqet e Prishtinës, e cila kërkoi të dijë se kur planifikohen të rregullohen apo të rinovohen këto lojëra dhe në cilën vijë buxhetore është paraparë renovimi apo mirëmbajtja e tyre.

Mbledhja përfundoi në orën 12:25.

Procesmbajtësi
Zijadin Gashi

Kryesuesi i Kuvendit
Halim Halimi, jur. i dipl.